

# NJOHJA ME KODIN E IESBA-së

## Pjesa 1: Pesë Parimet Themelore



Profesionistët Kontabël shpesh përballen me situata komplekse dhe të botës reale që nuk janë bardh e zi. *Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël* (“Kodi”) i rishikuar së fundi, hartuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Profesionistët Kontabël (IESBA), përcakton parimet për të udhëhequr sjelljen dhe për të ndihmuar profesionistët kontabël në përgjegjësinë e tyre për të vepruar në interes të publikut, edhe në situata komplekse.

Për shembull...

### **Ju jeni Drejtues i Politikave Kontabël për një kompani ndërkombëtare prodhuese:**

CEO ka bërë një propozim të ri biznesi për të nisur veprimtarinë në një treg në zhvillim. Plani është menduar të jetë në pajtueshmëri me legjislacionin lokal për rryshfetin dhe korrupsionin, por nuk jeni të sigurt nëse të gjithë do të pajtohen me këtë vlerësim.

### **Ju jeni një Menaxher Auditimi:**

Duke punuar për disa vite në auditimin e një kompanie private të shitjes me pakicë, ju e njihni mirë drejtimin e kompanisë dhe prisni që t’ju ofrohet një mundësi për të zëvendësuar Zëvendës Presidentin Ekzekutiv të Planifikimit Financiar që do të dalë së shpejtë në pension. Ju jeni të shqetësuar se pozicioni nuk mund t’ju ofrohet juve nëse janë identifikuar probleme gjatë auditimit të vitit aktual.

### **Ju jeni Zëvendës President i Financës në një kompani të bioteknikës së avancuar:**

Departamenti i marketingut sapo ka propozuar një politikë të re çmimesh për mbrojtjen e patentës, medikamente që shërbejnë për të shpëtuar jetë, që mund të konsiderohet si përfitim nga pacientë të dëshpëruar, të sëmurë kronik. Ju është kërkuar të bëni një analizë që mbështet çmimet e marketingut që drejtuesit duan të vendosin.

# PESË PARIMET THEMELORE QË NDIHMOJNË PROFESIONISTËT KONTABËL NË TRAJTIMIN E DILEMAVE ETIKE

## 1 INTEGRITETI

Jini të drejtpërdrejtë dhe të sqartë në të gjitha marrëdhëniet profesionale dhe të biznesit:

Si Drejtues, a keni vlerësuar ju frymën e planit të zgjerimit të CEO-s për të përcaktuar nëse ai mbështetet në mënyrë efektive në ndonjë ndikim të papërshtatshëm nga nënpunës qeveritar për të marrë miratimin për ndërtimin e një fabrike dhe shitje të produkteve?

## 2 OBJEKTIVITETI

Mos lejoni që paragjykimet, konfliktet e interesit ose ndikimi i tepruar i të tjerëve të kompromentojnë gjykimin profesional:

Si Menaxher Auditimi, duke qenë i vetëdijshëm për mundësinë e punësimit si Zëvendës President Ekzekutiv, a jeni i aftë të planifikoni dhe kryeni auditimin me një nivel të duhur skepticismi dhe kujdesi të duhur?

## 3 KOMPETENCA PROFESIONALE & KUJDESI I DUHUR

Gjithmonë zbatoni një nivel të duhur të njohurive profesionale, aftësive dhe kujdesit:

Si Drejtues, keni bërë punë mjaftueshëm për të kuptuar rregullat dhe rregulloret që drejtojnë korrupsionin në mënyrë që CEO juaj të mund të marrë vendimin e duhur në lidhje me zgjerimin në tregje të reja?

## 4 SJELLA PROFESIONALE

Veproni në pajtueshmëri me të gjitha ligjet dhe rregulloret dhe mos veproni në një mënyrë që mund të dëmtojë imazhin e profesionit:

Si Zëvendës President i Financës, a është analiza që ju keni përgatitur në mbështetje të politikës së re të çmimeve, e saktë dhe e drejtë, si dhe nuk do të konsiderohet si një informacion i paplotë dhe i njëanshëm që “justifikon” atë që departamenti i marketingut dëshiron të bëjë?

## 5 KONFIDENCIALITETI

Respektoni konfidencialitetin e informacionit të marrë për shkak të marrëdhënieve të biznesit dhe profesionale, në zbatim të ligjeve në fuqi:

Si Drejtues, ju zbuloni me vonë emailë që përshkruajnë një skemë për të transferuar mjete monetare tek nënpunës qeveritarë; si duhet ta komunikoni këtë informacion brenda kompanisë- përfshirë edhe CEO-n nëse është e nevojshme? Çfarë detyrimi keni për të njoftuar autoritetet ose për të dhënë informacione shpjeguese?

Megjithëse nuk është e mundur përcaktimi i çdo situatë, natyra e bazuar në parimet e Kodit është e rëndësishme për të gjithë profesionistët kontabël, pavarësisht nëse ata punojnë për një firmë kontabiliteti ose në një biznes. Edhe nëse nuk ka ndonjë kërkesë që është drejtpërdrejtë e zbatueshme në një situatë specifike, Pesë Parimet Themelore të përcaktuara në Kod ndihmojnë profesionistët kontabël të gjejnë rrugën e duhur – në përgjegjësinë e tyre profesionale për të vepruar në interes të publikut.

## KU MUND TË GJENDET INFORMACIONI I NEVOJSHËM?

Parimet Themelore gjenden në **Seksinin 110** të Kodit. Organizatave Profesionale — anëtare të IFAC— iu kërkohet të mbështesin anëtarët e tyre në zbatimin e Kodit. Prandaj, shoqatat ose institutet kombëtare për profesionistët kontabël janë shpesh vendi i parë ku shkojnë profesionistët kontabël për udhëzime dhe trajnime, kur ndeshen me dilema etike. Sekcioni **Krijimi i Besimit dhe Etikës** në IFAC Knowledge Gateway ofron një burim të pasur për profesionistët kontabël, përfshirë këtë artikull si edhe artikullin e Majit 2019 të titulluar **Të Paguash Etikën Profesionale më Shumë sesa Shërbimet Estetike**.



ECode, i cili është i disponueshëm në [www.IESBAeCode.org](http://www.IESBAeCode.org), është një burim online për profesionistët kontabël dhe përdoruesit e tjerë të Kodit. Ai siguron akses të shpejtë dhe eficient në Kod, duke e bërë atë më të lehtë për tu përdorur, implementuar dhe zbatuar.



Pjesa tjetër e *Njohjes së Kodit të IESBA* do të prezantojë Kuadrin Konceptual të Kodit, i cili është krijuar për të ndihmuar profesionistin kontabël kur ndeshet me “kërcënime” që ndikojnë në aftësinë e tij për të vepruar në pajtueshmëri me Parimet Themelore. Informacion shtesë rreth IESBA-së dhe Kodit është i disponueshëm në website-in e IESBA-së.

“Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 1: Pesë Parimet Themelore”, publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në Nëntor 2019 në gjuhën angleze, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në Qershor 2020, dhe është riprodhuar me lejen e IFAC. Teksti i aprovuar i të gjitha publikimeve të IFAC është ai i publikuar nga IFAC në gjuhën angleze. IFAC nuk mban përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e përkthimit ose për veprimet që mund të rrjedhin prej tyre.

Teksti në gjuhën angleze “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 1: Pesë Parimet Themelore” © 2020 nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Teksti në gjuhën shqipe “Njohja me Kodin e IESBA-së Pjesa 1: Pesë Parimet Themelore” © [2020] nga IFAC. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Titulli origjinal: “Exploring the IESBA Code Installment 1 - The Five Fundamental Principles”

Kontakttoni [Permissions@ifac.org](mailto:Permissions@ifac.org) për marrjen e lejes për të riprodhuar, ruajtur, shpërndarë, apo për përdorime të tjera të ngjashme të këtij dokumenti.